



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.42

Prishtinë, më 27.9.2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Bekë Berisha, kryetar i Komisionit, Enver Dugolli, zëvendëskryetar i parë, Erxhan Galushi, nënkryetar i dytë, Shqipe Mehmeti-Selimi, Mefail Bajqinovci, Anton Quni, Hisen Berisha dhe Fatmir Humolli.

Mungouan: Arber Rexhaj dhe Slavko Simiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Besnik Fetahu, këshilltar i Grupit Parlamentar të VV, Shukrie Stublla, këshilltare juridike -Kuvendi i Kosovës dhe Shqipe Shala, këshilltare juridike -Kuvendi i Kosovës.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku, koordinator dhe Hana Bajraktari, zyrtare e fushës.

Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-166 për Tubimet Publike;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar;
5. Të Ndryshme.

Kryesuesi i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-166 për Tubimet Publike.

Kryetari, theksoi se në bazë të rregullores së Kuvendit, jemi ngarkuar si Komision për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-166 për tubime publike dhe nga Komisioni kërkohet të shqyrtohet në parim. Gjithashtu propozoi edhe formimin e grupit punues.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës shqyrtoi në parim Projektligjin Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike dhe me votat unanime nxori këtë :

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligjin Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike. Komisioni vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij në parim.

Kryetari, hodhi në votim edhe përbërjen e grupit punues.

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike me këtë përbërje: Rashit Qalaj, kryesues, Enver Dugolli, Erxhan Galushi dhe Anton Quni, anëtarë.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike.

Kryetari, theksoi se në bazë të rregullores së Kuvendit ne ngarkohemi si Komision për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-173 për sigurinë Kibernetike dhe nga Komisioni kërkohet të shqyrtohet në parim.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike dhe me votat unanime nxori këtë :

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike. Komisioni vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij në parim.

Kryetari, hodhi në votim edhe përbërjen e grupit punues.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

V E N D I M

Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike me këtë përbërje: Mefail Bajqinovci, kryesues, Anton Quni, Shqipe Selimi, anëtarë.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar

Kryetari, theksoi se në bazë të rregullores së Kuvendit ne ngarkohemi si Komision për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar dhe nga Komisioni kërkohet të shqyrtohet në parim.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës shqyrtoi në parim Projektligjin Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar dhe me votat unanime nxori këtë :

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligjin Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar Komisioni vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij në parim.

Kryetari, hodhi në votim edhe përbërjen e grupit punues.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit t ditës me vota unanime nxori këtë:

V E N D I M

Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, me këtë përbërje: Fatmir Humolli, kryesues, Bekë Berisha, Enver Dugolli dhe Hisen Berisha, anëtarë.

5. Të ndryshme

Tutje Komisioni vendosi që mbledhja të vazhdojë me dyer të mbyllura .

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Bekë Berisha,
Kryetar i Komisionit
